



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI REGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT  
REGULATORNI AUTORITETI ZA USLUGE VODE  
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	29.12.2023
Autoriteti Regulator për Shërbimet e Ujit Regulatorni Autoritet za Usluge Vode Water Services Regulatory Authority	
Nr. protokoll. referenc. No	834
Nr. shtesa. Akti. Sh. Akti. No	D
Dati/Datum: 29.12.2023	
FASHKIMË - PRISTINA - PRISTINA	

NR.01/2024

## UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 01/2024 PËR PËRCAKTIMIN E LARTËSIS SË TAKSËS VJETORE TË LICENCIMIT TË OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOVË

Neni 1  
Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet lartësia e taksës vjetore dhe paraqitet metodologjia e kalkulimit të taksës që duhet ti paguhet Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (në tekstin e mëtejshëm: ("ARRU"), nga të ardhurat bruto të ofruesit të shërbimeve, të cilët janë licencuar nga ARRU.

Neni 2  
Fushëveprimi

Udhëzim Administrativ përcakton temat, kushtet dhe procedurat Ofruesit të Shërbimeve të Ujësjetësit, Ujërave të Ndotura dhe Furnizuesit e Ujit me Shumicë, krejt së bashku Ofrues të Shërbimeve, dhe në rast të bashkimit (shkritjes) të ndonjë Ofruesi të Shërbimeve me një ose më tepër Ofrues të Shërbimeve, pasardhësin e tij.

Neni 3  
Taksa e Aplikimit për Licencë

Ofruesi i shërbimeve i paguan ARRU taksën e pakthyeshme të paraparë me nenin 14 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L-042, në shumën prej 200.00 € (dyqind euro), për paraqitjen e aplikacionit, në ditën kur aplikacioni për lëshimin ose përtëritjen e licencës për shërbime i është dorëzuar ARRU-së.

**Neni 4**  
**Taksa Vjetore e Licencimit**

1. Ofruesi i shërbimeve i paguan ARRU taksen e pakthyeshme vjetore të licencimit për vitin që fillon me 1 janar 2024 në pajtim me nenin 14 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-042.
- Lartësia vjetore e Taksës së licencimit është përcaktuar të jetë **1.21 %** e bruto faturmimit vjetor të raportuara në pasqyrat e të ardhurave të tyre për vitin 2021 të atij Ofruesi të Shërbimeve të Ujit sipas shtojcës dy (2) të këtij udhëzimi.

$$\underline{X = B \times 100/t}$$

*X = Vlera e Taksës Vjetore të Licencimit e pageshme nga secili Ofrues i Shërbimeve*

*B = Shpenzimet e parapara të ARRU për vitin 2024 (shih Shtojcën 1)*

*t = Qarkullimi vjetor bruto i Ofruesit të Shërbimeve për vitin 2022 (shih Shtojcën 2)*

2. Në rast se një Ofrues i Shërbimeve është bashkuar me një apo më tepër Ofrues të Shërbimeve të Ujit, pasardhësi i tij duhet të paguajë taksen vjetore të licencimit që është e pageshme nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit që është bashkuar (shkrittë).
3. Të gjithë Ofruesit e Shërbimeve të Ujit, dhe furnizuesit të ujit me shumicë, të Licencuar nga ARRU janë të obliguar të paguajnë Taksën Vjetore të Licencimit e cila është e ndarë në dymbëdhjetë (12) kështe të barabarta në çdo fillim të muajit të vitit kalendarik më së voni deri më datën pesë (5).

**Neni 5**

**Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr.01/2023 për përcaktimin e lartësisë së taksës vjetore për vitin 2023.

**Neni 6**

**Hyrja në Fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ për Përcaktimin e Lartësisë së Taksës Vjetore, hynë në fuqi me 1 janar 2024

Datë 29 / 12 / 2023

Prishtinë



Drejtoresha e ARRU

Hajrije Morina

**Bashkangjitur në këtë udhëzim janë edhe shtojcat si në vijim:**

*Shtojca 1: Shpenzimet ARRU-s sipas kufijve të fortë të buxhetit për vitin 2024*

*Shtojca 2: Qarkullimi Vjetor i Ofruesve të Shërbimeve në 2022 të audituara dhe*

*Lartësia e Taksës Vjetore të Licencimit për Ofruesit e Shërbimeve për 2024*

**Shtojca 1: Shpenzimet Totale të ARRU- të sipas kufijve të fortë buxhetor për vitin 2024**

<b>SHPENZIMET TOTALE TË ARRU NË 2023</b>	
<b>1. Shpenzimet e Personelit</b>	<b>243,332.00</b>
<b>2. Shpenzimet e Mallërave dhe Shërbimeve</b>	<b>138,941.00</b>
<b>3. Shpenzimet e Shërbimeve Publike</b>	<b>6,503.00</b>
<b>4. Investime Kapitale</b>	<b>100,000.00</b>
<b>Gjithësejt Shpenzimet e ARRU</b>	
	<b>488,776.00€</b>

**SHËRRIMET E UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA DHE UJIT ME SHUMICË 2022**

Emri i Ofruesit të Shërbimeve	Regjioni	Qarkullimi bruto vjetor (EUR)
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "PRISHTINA" sh.a.	Prishtina	15,783,436
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "BIFURKACIONI" sh.a.	Ferizaj	2,449,715
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "GJAKOVA" sh.a.	Gjakovë	4,427,671
Ofruesi I Ujit me Shumicë "IBER-LEPENCI" sh.a.	Prishtinë	1,451,789
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "MITROVICA" sh.a.	Mitrovicë	4,428,640
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "HIDRODRINI" sh.a.	Pejë	4,264,339
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "HIDROREGJIONI" sh.a.	Prizren	5,299,963
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "HIDROMORAVA" sh.a.	Gjilan	2,323,811
<b>Totali – Ofruesit shërbimeve te Ujit</b>		<b>40,429,363€</b>

**TAKSA VJETORE PER OFRUESIT E SHËRRIMEVE PER VITIN 2024**

Emri I Ofruesit te Shërbimeve	Regjioni	Lartësia e takses vjetore
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "PRISHTINA "	Prishtine	190,979.58
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "BIFURKACIONI"	Ferizaj	29,641.55
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "GJAKOVA "	Gjakove	53,574.82
Ofruesi I Ujit me Shumicë "IBER-LEPENCI"	Prishtine	17,566.65
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "UJESIELLSI REGIONAL "	Mitrovice	53,586.54
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "HIDRODRINI"	Peje	51,598.50
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "HIDROREGJIONI"	Prizren	64,129.55
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "HIDROMORAVA "	Gjilan	28,118.11
<b>Total taksa vjetore 2024</b>		<b>489,195.30</b>

*Shtojca 2: Qarkullimi Vjetor i Ofruesve të Shërbimeve në vitin 2022 të audituar nga ARRU si dhe Taksa vjetore e Licencimit për vitin 2024*